

Ismete Puka

Punëtore teknike në shtypshkronjë



Në foto: Ismete Puka

Nga arkivi personal i Ismete Pukës

Unë kom lindë në Prishtinë, edhe kom pasë shumë shoqe, nja pesë a gjashtë kemi qenë, po qaq kënaqësi kur u bojshim bashkë, edhe ishte ajo zakon, që kur të qohesh në mëngjes, me pastru para shpisë, rrugën. E u shtyjshim tash, cila po del ma herët, e mandej fillojshim me lujtë me lodrat e atëhershmit, nuk kemi pasë ksi topa domethonë, po lujshim me arra me to, interesant n'murë [*imiton zhurmën e arrave në murë*] kush po bon ma shumë, edhe qasi lodra. Kcejshim në konop e, lujshim msheftas e, si zakonisht në kohën e atëhershmit.

<<< Ambient i lagjes me fëmijë duke luajtur >>>

Kështu që kënaqësi, kënaqësi, ato ma shumë më kujtohen, edhe shpija më kujtohet, ku kom lindë e ku jom rritë e, ajo lagjja aty, spo di si me thonë po, kënaqësi e madhe. Në atë kohë edhe kanë qenë edhe oborret, kanë qenë shpijat, e kur gatujshim jashtë shpisë, si i kanë thonë atëherë "*Mutfak*" i thojshin turqisht, ajo era vijke në rrugë, u konë ni shoqe sërbe, u shoqnojshim edhe me serbet po, "Uh" thojke "që e ka bo Zyrefa inxhja", thojke, "piten", apo, "taven" apo... E kështu që nuk kemi pasë, kështut, në atë kohë se kush çka osht', kryesorja me qenë bashkë edhe qashtu ishte koha, edhe na fëmijtë s'ishim fort të interesumë. Në shkollë kom kalu mirë, po nuk kom qenë domethonë, ashtut shembull me thonë, a din, po mirë, në atë kohë edhe pesëshen e ke marrë vshtirë [*qeshë*]. E u kry ajo shkolla, e mandej fatkeqësi pata në prill, te baba, në vend të punës ai humbi jetën se ni aksident ka pasë, e kështu që metëm na me nanën e me gjashtë fëmijë, motra e madhe ishte e martune. E tash unë, 16 vjet e gjysë kur më ka vdekë baba, edhe p'i thom nanës, "Du me hi në punë, me punu", e deri sa kom hi në punë,

punojsha me krrabza kojshive aty me ju bo shallat, kapuqat, dorëzat, diçka që mos me iu bo barrë nanës. Veç ni kujtim që e di që nana ma ka plotësu shumë dëshirën, që i shiti ni parë dimi e me ma ble ni fustan, e atë fustan e rujsha mo... si në atë kohë.

E kur hina në punë 16 vjeçe [*mendohef*] jo, 18 veçe, edhe me i nihmu nanës, nana e re, ku do të punësohna? Edhe mendova për Rilindje me u punësu. Edhe isha afër shpisë, se mas teatrit, kah rruga e parkut, aty në rreth shpija e prindve, qaty ku jom rritë. Edhe thash “Afër e kom nanë këtu”, edhe po shkoj thash “Duhet me punu diçka me të nihmu”. Vëllaun e kisha ushtar, këta tjetër dy vllazën e motra ishin në shkollë të gjithë, po në atë kohë pensionin shteti e ka pagu shumë mirë, si dhe rasti i babës që ka qenë në vend të punës, aksidenti, nana e ka marrë pensionin shumë të mirë. Edhe shtesë fëmijtë kanë marrë deri sa kanë qenë në shkollë, veç me ja qu vërtetimin edhe ti e ke marrë qat’ shtesë. Epo prap, ajo [*ofshanë*] m’u dhimke nona, se u dufke pak prej fillimit me menu deri në fund të mujit. Edhe u lajmërova aty në punë, në Rilindje, edhe meniherë më pranunë. Kur aplikova une për punë, edhe m’kishin pranu, se u dufke me u mbajtë mbledhja e Këshillit të Punëtorëve, grafike, edhe ata kanë vendosë për me më pranu. Edhe u pranova, kur fillova me punu, p’i shoh disa shoqe në klasë që i kom pasë.

Unë kur u punësova aty, gjashtë mujë ditë e kishin si praktikë, po une dyqysh nuk mujsha gjashtë mujë ditë më pritë, me marrë maqinën me shtypë. I shifsha ato koleget e tjera po shtypin, “E unë?”, ju thash “Shka me bo këtu?”, “Ti”, tha, “Me shku, me i vizitu, me u mësu”. Ish ai kryepunëtori e p’i thom, “Jo, unë gjashtë mujë nuk pres”, e p’i thom njonit, thash “A e din ti kur jonë këta pushim, e me hi me më mësu, për me shtypë”. Se ish, tabktë ishin naltë, u dufshe nga nji me marrë, e me shti, e me shku ajo e m’u shtypë, e m’u gjujtë në pjesën tjetër. Edhe unë fillova qashtut, gabova shumë, ni kohë gabova qashtut, tha, “Qeto krejtë”, tha, “Duhet m’u hudhë” tha, “veç nesër fillojmë prap”. Unë të nestrit prej gëzimit “Hajt”, thash, “Njëherë gabva, ndoshta s’do të gaboje mo”, e saktë. Kur ai kryepunëtori po vjen, ky si e pat emrin [*mendohef*], s’po më kujtohet. Kur po më sheh mu në maqinë t’u punu, “Ismete” tha, “Shka je ka bon?” thash “Shka jom ka boj?”, thash, “S’po du veç me nejtë, me kqyrë, shumë mirë, ajo praktika osht’ shumë e mirë”, thash, “Se pa u mësu pak unë s’kisha ditë edhe me marrë”. Thash, “Po të tregoj drejtë, se dje”, thash, “Kom gabu pak, i kena hudhë ato”. “U” tha “Çfarë s’osht’ problemi ajo, po po më vjen mirë, që pate thonë, “Unë dy, tri javë, ma shumë nuk rri në praktikë, du mu msu”. Edhe meniherë i dhashë vetit vullnet, edhe kështu që fillova me punu.

Unë u punësova në punë, edhe po më thojnë, “Hajt shko te evidenti aty, m’u lajmëru, që me hi në rend të punës”. Edhe po shkoj, se ai (burri) punojke në katin e dytë, në shtypshkronjë të vjetër sa kem qenë, a Reparti i Shtypit ka qenë poshtë. Edhe tash, burri, ai më kqyrë, më shef, edhe i pëlqej, pe qon këtë [*mendohef*] njoni gjakovar si e patë emrin, thotë, “Shko veç provo a osht’ sërbe, a o shqiptare a çka, a din veç më pelqej”. Vjen edhe pytë tjetër edhe i thotë, “Jo more prishtevkë” thotë osht’, “E din shqipen, din turqishten”, edhe po vjen po thotë, “Qeshtu, qeshtu”, thash, “Lemni rahat more, sa erdha unë në punë” thash, “E tash mu marrë unë me dashnia, jo”, edhe e refuzova ni herë, e refuzova dy herë, Qamili Vogël ma shumë u qit, se ai gjakovar.

<<< Pjesë e shkëputur nga kënga “Pasha sytë e mi” nga Qamili Vogël >>>

Edhe “Jo, djalë i mirë e”, kështu me të vërtetë edhe në pamje ka qenë i mirë, po, megjithëse pamja nuk osht’, po në atë kohë pak kena kërku valla me pasë pak [qeshë], nejse, veq qaj xham na ka nda.¹ Shumë e kom pasë burrin si me t’thanë, shpirtbardhë, kurrë në jetë s’mu ka përzi, me thanë, “Pse qishtu ti a, pse ashtut a?”. E domethanë kemi kalu shumë të lumtur, edhe fëmitë i kemi mujtë...sa kena mujtë me i eduku e, m’i shkollu, m’u ngritë.



Mbrëmja e përvjetorit të Rilindjes, 12 shkurt 1982

Në foto: Ismete Puka dhe Muharrem Puka

Nga arkivi personal i Ismete Pukës

U konë në ora gjashtë, verës ka fillu, orari i punës, në ora gjashtë, edhe deri në ora dy. Tetë orë u plotësojke. E dimrit prej orës shtatë, deri në ora tre. Ato fletët, ato u dufke m’i palu, u konë ni kolege Sheherzada u qujke, e Bosnës, si kanë ardhë prej tona anëve aty, që u hap Rilindja, u hapën puntë në të gjitha antë. E ai kryepunëtori Abdurrahman Sekiraqa ka qenë, e këqyrke tash çdo maqinë qysh jonë palu ato (fletët) që kanë me shku për libërlidhje, ata mandej vishin, i mershin prej neve edhe atje i prejshin, i palojsin. E, e kqyrshke [qeshë] “Qyre qita Ismetja me Sheherzaden e kanë, ato kur t’palojnë”, thojke, “Palojnë si qibrit”. E kështu që punën duhesh me marrë me seriozitet. E kush kryjke, e tash vike puna, pe zo’ 1000 copa për tetë orë i ki, e tash për qat tetë orë normën e ki qikaq mijë copa mi shti, e nëse ti munesh m’i tejkalu, atëhere merr edhe shtesë, orë. E tash mos ta livdoj vetën, se mu duke ajo “Pse nuk muj?”, çdo ditë kah dy

¹ Lu referohet xhamit në murin ndarës në mes të dy hapësirave punuse të saj dhe të burrit

orë i tejkalojsha. E me Qamilin që kom punu nja tetë vjetë, Qamili nuk, Qamili i Vogël, ai nuk ish interesu, se u merrke me libra që shtypke, me kangë e, me anej e knej, “Qamil formoma faqen t’a shtypi”, “Hajt, hajt” thojke “Ismete se boll kena mushë normën, shko te koleget aty bon muhabet pak, e lirohu pak prej maqines”, e unë prap shkojsha, shka rrijsha, e prap u kthejsha “Jo se dy orë du m’i kry”.

<<< *Ambient i punës në shtypshronjë* >>>

Ambienti në Rilindje të vjetër ka qenë shumë i mirë, se oborri, dyrtë i lishim çelë, oborri ma fresktë. A këtu në Rilindje në grafikë, ku kom punu, ambienti shumë i mbyllun. Ai reparti shumë i madh, sa me thanë me qindra metër, se nuk ka qenë ni maqinë, po kanë qenë nja dhetë ndoshta, disa ma të mëdhaja, disa ma të vogëla, disa me dorë. E shtrojë nuk ka pasë poshtë se beton, se aty janë la valaktë, ato valaktë u duftë me ngjyrë me i ly, mandej, tasht qit’ ngjyrë u duftë dika me dalë ajo, jon duftë ata valaktë mu ly edhe m’u sjellë ata valaktë deri sa të vjen me marrë faqen, ti që ja jep faqën për me ta shtypë.

U smuva, më dhimke gjoksi, edhe shkova m’u mjeku më tha, “Teta nuk bon aty me punu”, se mora kronik, sëmundjen kornike të mushknive. Mandej une dola herët në pension. Une kom dalë pa i mushë 50 vjet, në ‘98-tën, [*mendohe*] jo, në ‘89-tën e mandej në shkurt, me 2 shkurt u bo që me i lëshu puntë si grevë shqiptartë, shumë gabumë. Kishe me mbri diçka, që kundra tyne, po kanë metë shumë pa punë, u vorfnu populli shumë.